



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 maj 2014
Nr.ref.:RK 575/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI78/13

Parashtrues

Roland Bartetzko

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me
Kusht, MD/CRP-nr. 474/12, të 29 dhjetorit 2012 dhe Udhëzimit
Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Drejtësisë**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Roland Bartetzko, shtetas gjerman (në tekstin e mëtejme: parashtruesi). Ai është në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës, afër Istogut, Kosovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin MD/CRP-nr. 474/12 të Panelit për Lirim me Kusht të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Paneli për Lirim me Kusht), të 29 dhjetorit 2012, i cili i është dorëzuar atij më 4 mars 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të jetë jokushtetues, sepse është dorëzuar pa pajtimin e parashtruesit.
4. Gjithashtu, parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Drejtësisë.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 3 korrik 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 20 korrik 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI78/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI78/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama - Hajrizi.
8. Më 11 shtator 2013, Paneli për Lirim me Kusht u njoftua për kërkesën.
9. Më 20 janar 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i kësaj Gjykate i paraqiti rekomandimin Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 12 nëntor 2002, Gjykata Supreme e Kosovës (S. C. Ap. nr. 181-2002) e shpalli parashtruesin fajtor për veprën penale të terrorizmit, siç përcaktohet me nenin 125 në lidhje me nenin 139 paragrafi 2 i Kodit Penal të Jugosllavisë. Gjykata Supreme gjithashtu e ndryshoi dënimin e tij në 20 vjet burgim, duke përfshirë kohën e kaluar në paraburgim, që nga 20 prilli 2001.
11. Më 25 nëntor 2011, parashtruesi u njoftua se që nga 20 prilli 2011, ai është i kualifikuar për shqyrtim për "*lirim të mundshëm me kusht*" nga burgu.

12. Më 25 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij për *“lirim me kusht”*.
13. Më 28 dhjetor 2011, Paneli për Lirim me Kusht (Vendimi PLK. nr. 224/11) e refuzoi kërkesën për lirim me kusht, të dorëzuar nga parashtruesi. Për më tepër, në vendim thuhej, *“Kërkesa e re do të shqyrtohet pas një (1) viti”*.
14. Parashtruesi i kërkesës nuk ka parashtruar kërkesë të re për *“lirim me kusht”*.
15. Më 29 dhjetor 2012, Paneli për Lirim me Kusht (Aktvendimi MD/PLK. nr. 474/12) *ex officio* e refuzoi kërkesën për lirim me kusht. Për më tepër, në vendim thuhej se, *“kërkesa e re do të shqyrtohet pas nëntë (9) muajve”*.
16. Më 8 mars 2013, parashtruesi i kërkesës kërkoi shpjegim nga Paneli për Lirim me Kusht në lidhje me procedurën e shqyrtimit të lirimit me kusht në rastin e tij.
17. Më 15 mars 2013, Paneli për Lirim me Kusht (ref. nr. 34) iu përgjigj parashtruesit të kërkesës duke theksuar si në vijim: *“sipas ligjit në fuqi, paneli ka autoritet të plotë për t'i caktuar datat e shqyrtimit të kërkesave. Në Aktvendimin e Panelit të 28 dhjetorit 2011, shqyrtimi i kërkesës së re, për të njëjtin është caktuar që të mbahet pas një (1) viti pas marrjes së Aktvendimit (Aktvendimi i bashkëngjitur). Sipas këtij Aktvendimi, institucioni korrektues është udhëzuar ta dorëzojë dosjen personale të z. Bartetzko dhe raportin e ripërtërirë sipas rregullave procedurale (Urdhrat: PLK 2009/1 që e rregullojnë punën e panelit për lirim me kusht, nenet 15 dhe 32, paragrafët 1,3 dhe 4)”*.
18. Për më tepër, Paneli për Lirim me Kusht, në përgjigjen e vet theksoi se *“procedura e lirimit me kusht dhe themeli i kërkesës çdoherë bazohen në raportet korrektuese dhe sipas këtij përkufizimi, vlen deklarata e mëparshme e të dënuarit (e 25.11.2011), kështu që nuk është e detyrueshme që në çdo periudhë të rishqyrtimit të formulohen kërkesa të reja me të njëjtat pretendime, ngase sipas ligjit, rishqyrtimi bëhet në mënyrë automatike dhe sigurisht e dini se në këtë rast ne kemi të bëjmë me rishqyrtim dhe jo ri-aplikim”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi pretendon se kërkesa për *“lirim me kusht”* është jokushtetuese dhe duhet të anulohet, pasi që ishte parashtruar pa pajtimin e tij. Parashtruesi deklaroi se diku në tetor të vitit 2012, derisa ai ishte në trajtim në Qendrën e Klinikës Universitare të Kosovës, një punëtor social nga Dubrava kishte kërkuar nga parashtruesi të nënshkruajë një dokument, në të cilin thuhej *“ne ju njoftojmë se ju tani jeni i kualifikuar për shqyrtim për lirim me kusht”* dhe se punëtori social kishte deklaruar se nëse do të dëshironte dhe kur do të dëshironte parashtruesi, ai do të mund të paraqiste kërkesë tek oficeri përkatës në burgun e Dubravës.
20. Parashtruesi argumenton se në atë kohë ai nuk dëshironte të paraqiste kërkesë dhe veçse më 4 mars 2013, oficeri korrektues ia kishte dorëzuar parashtruesit

Vendimin MD/PLK. nr. 474/12, të 29 dhjetorit 2012, i cili u dorëzua me faks në burgun e Dubravës, më 9 shkurt 2013.

21. Për më tepër, parashtruesi kërkoi se *“për shkak të rëndësisë dhe interesit publik, Gjykata Kushtetuese të jep vlerësim sipas detyrës zyrtare të kushtetutshmërisë së neneve 16 dhe 34 të Udhëzimit Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Drejtësisë”*.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për ankesën e parashtruesit, duhet që së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh se *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: kërkesa është qartazi e bazuar”*.
24. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të theksojë se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga Paneli për Lirim me Kusht, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Prandaj, kjo Gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga autoritet publike.
25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova se të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar nga Paneli për Lirim me Kusht. Gjykata vëren se në Vendimin PLK. nr. 224/11, të 28 dhjetorit 2011, të Panelit për Lirim me Kusht përmendet në mënyrë eksplicite se rasti i parashtruesit do të shqyrtohet pas një viti, siç ndodhi më 29 dhjetor 2012. Prandaj, Gjykata nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
26. Në rastin konkret, parashtruesi gjithashtu kërkon *“Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës”*. Kushtetuta në nenin 113 qartazi e përcakton se kush mund të kërkojë vlerësim abstrakt të kushtetutshmërisë së rregulloreve të Qeverisë.
27. Një kërkesë e tillë është një kontestim abstrakt i Udhëzimit të lartpërmendur dhe Ligjit. Nëse ky është qëllimi i parashtruesit si një individ, ai nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar për të kërkuar një vlerësim të tillë nga Gjykata.
28. Nenet 113.2, 113.6 dhe 113.8 të Kushtetutës përcaktojnë në mënyrë eksplicite cilat janë palët e autorizuar që mund t’i drejtohen Gjykatës në lidhje me vlerësimin abstrakt të kushtetutshmërisë së udhëzimeve administrative.

29. Gjykata vëren se në këtë rast parashtruesit i mungon “pozita” ose autoriteti në Gjykatë, sepse parashtruesi nuk i ka plotësuar kriteret procedurale të nenit 113.1 të Kushtetutës. Përveç kësaj, sistemi kushtetues juridik i Kosovës nuk i lejon mundësinë mbi bazën e teorisë “*actio popularis*” asnjë individ që dëshiron të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me rastin e shkeljes së tillë edhe kur ai/ajo nuk e ka statusin e viktimës.
30. Si përmbledhje, parashtruesi nuk ka treguar pse dhe si janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, rregullit 36 (1) c) dhe rregullit 55 (5) të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve, dhe të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani